



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave  
Regulativni Autoritet Železnica  
Railway Regulatory Authority



Në mbështetje të nenit 38, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, Bordi i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave miraton:

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO			
AUTORITETI RREGULLATIV I HEKURUDHAVE / REGULATIVNI AUTORITETI ŽELEZNICA / RAILWAY REGULATORY AUTHORITY			
DEP/SEK. DEP/SEK. DEP/SEK:	01	NR PROT BR PROT NR PROT:	483
NUMRI I FAQEVE BROJ STRANA NR OF PAGES	5	DD.MM.VVVV DD.MM.GGGG DD.MM.YYYY:	12/06/2017
PRISHTINE / A			

**Rregullore Nr. 03/2017 për të Drejtat e Udhëtarëve**

Rr. Rrustem Statovci nr.29  
Prishtinë, Kosovë  
Tel:+381 38 22 00 40  
Fax:+381 38 22 33 40  
Web:www.arh-ks.org

Kuvendi i Kosovës  
Skupština Kosova  
Assembly of Kosovo

## **Neni 1**

### **Qëllimi**

1.1 Kjo rregullore ka për qëllim që dispozitat e sajë gjatë aplikimit të garantojnë të drejtat e meritura për udhëtarët, të cilët udhëtojnë me trena brenda territorit të Republikës së Kosovës. Për ARH-në është e rëndësishme që të mbrohen të drejtat e udhëtarëve dhe që të përmirësohet kualiteti dhe efikasiteti i shërbimeve hekurudhore të pasagjerëve, në mënyrë që të ndihmohet në rritjen e përdorimit të transportit hekurudhor në krahasim me mënyrat e tjera të transportit.

## **Neni 2**

### **Fushëveprimi**

2.1 Dispozitat e kësaj Rregullore aplikohen dhe janë të detyrueshme në të gjitha udhëtimet me tren të ofruar nga një ose më shumë ndërmarrje hekurudhore të licencuar në Republikën e Kosovës, në përputhje me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës 04/L-063, dhe Direktivën e BE-së, 1371/2007.

## **Neni 3**

### **Kontrata e transportit**

3.1 Ndërmarrjet hekurudhore, apo kur është e përshtatshme autoritetet kompetente përgjegjëse për kontratat e shërbimeve publike hekurudhore, me mjetet e përshtatshme duhet të bëjnë publike edhe para zbatimit të tyre, vendimet për mos vazhdimin e shërbimeve.

## **Neni 4**

### **Informatat para udhëtimit**

4.1 Ndërmarrjet hekurudhore dhe shitësit e biletave që ofrojnë kontrata të transportit në emër të një apo më shumë ndërmarrjeve hekurudhore duhet të u ofrojnë udhëtarëve me kërkesë të tyre së paku këto informata.

- 4.1.1 Cilat kushte të përgjithshme zbatohen në kontratë?
- 4.1.2 Cili është udhëtimi më i shpejtë dhe cili ka çmimet më të ulëta?
- 4.1.3 A ka pajisje për personat me aftësi të kufizuar dhe personat me lëvizshmëri të kufizuar si dhe të udhëtarëve me biçikleta përderisa hyjnë në tren dhe në bord (hapësira ku qëndrojnë udhëtarët)?
- 4.1.4 A ka ulëse në vende për pirjen dhe mos pirjen e duhanit, ndarje në klasë të parë dhe të dytë, si dhe vagon gjumi?
- 4.1.5 A do të ndalet ose vonohet udhëtimi?
- 4.1.6 Çfarë lloje të shërbimeve janë të ofruara në bord (Vagon)?
- 4.1.7 Ku dhe si mund të kërkojnë bagazhet e humbura dhe si ta paraqesë ankesën?

